VENDIM
Nr.52, datë 14.7. 2004

PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË KREDISË

Baza ligjore
Neni 1

Kjo rregullore hartohet në mbështetje të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", neni 12 germa “a”, të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", neni 26 pika 3 germa”b”; neni 28; neni 31 pika 2; neni 36 dhe neni 37.

Qëllimi
Neni 2

Qëllimi i kësaj rregulloreje është administrimi i rrezikut të kredisë në mënyrë që banka të minimizojë humbjet e mundshme nga kreditë dhe nga aktivet e tjera të ngjashme me to dhe të ndjeshme ndaj lëvizjeve të normave të interesit (më poshtë, aktive të tjera).

Në këtë rregullore përcaktohen kriteret, kategoritë dhe metodat e klasifikimit të kredive dhe të aktiveve të tjera të bankës, duke llogaritur një nivel të përshtatshëm fondesh rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga pamundësia e rekuperimit të vlerës së plotë të tyre.

Për nevojat e kësaj rregulloreje, me rrezik të kredisë kuptohet pamundësia e kredimarrësit dhe e garantuesit të kredisë ose e kundërpartisë për aktivet e tjera, për të përmbushur detyrimet ndaj bankës sipas kushteve të marrëveshjes të lidhur mes tyre.

Subjektet
Neni 3

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat, degët e bankave të huaja dhe subjektet e tjera jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë për dhënien e kredive. Në vijim të kësaj rregulloreje, këto subjekte do të njihen me termin “bankë”.

Klasifikimi i kredive
Neni 4

4.1 Bankat klasifikojnë kreditë e tyre në një nga pesë kategoritë e mëposhtme:

1. kredi standarde,
2. kredi në ndjekje,
3. kredi nënstandarde,
4. kredi të dyshimta,
5. kredi të humbura.

Kategoria 1 përfaqëson cilësinë më të lartë të kredisë, ndërsa kategaria 5 përfaqëson cilësinë më të ulët të kredisë.

4.2 Kreditë e klasifikuara në kategoritë 1 dhe 2 përbëjnë grupin e kredive cilësore. Shuma bruto (kryegjë + interes) e tyre përbën totalin e kredive cilësore.

4.3 Kreditë e klasifikuara në kategoritë 3, 4, 5 përbëjnë grupin e kredive me probleme. Shuma bruto (kryegjë + interes) e tyre përbën totalin e kredive me probleme.

Karakteristikat për klasifikimin e kredive
Neni 5

5.1 Për klasifikimin e kredive sipas kategorive të mësipërme, banka analizon sipas përparësisë dhe në mënyrë plotësuese, karakteristikat e mëposhtme :

a) gjendjen financiare të kredimarrësit, analiza e së cilës konsiderohet parësore në klasifikimin e kredive;

b) gjendjen financiare të garantuesit të kredisë, kur banka nuk krijon bindje ose ka vështirësi

për klasifikimin e kredisë, duke u mbështetur vetëm në karakteristikën “a”;

c) sigurimin e kredisë të mbështetur në analizën dhe në vlerësimin e cilësisë së kolateralit dhe/ose të garancisë, kur kolaterali dhe/ose garancia ekzistojnë. Analiza e sigurimit të kredisë, duke qenë në vazhdimësi një element i nevojshëm, bëhet e domosdoshme kur banka nuk krijon bindje ose ka vështirësi për klasifikimin e kredisë duke u mbështetur vetëm në karakteristikën “a”;

d) ditëvonesat në shlyerjen e kredisë, si të kryegjësë, ashtu edhe të interesit, të cilat konsiderohen një arsye për bankat për të bërë riklasifikimin e kredive;

e) lëvizjet në llogari për kreditë kufi, me përjashtim të riklasifikimit, të regjistrimit të interesave të llogaritur apo të kapitalizimit të tyre, si edhe të kthimit të kredisë me qëllim përfitimin e menjëhershëm të një kredie me vlerë më të madhe, në kushtet, kur nuk ka pasur lëvizje në llogari për shlyerje të mëparshme . Kjo analizë fiton rëndësi më të madhe, kur banka nuk krijon bindje ose ka vështirësi për klasifikimin e kredisë, duke u mbështetur vetëm në karakteristikat e mësipërme;

f) ristrukturimi i kredisë si rezultat i paaftësisë për ta shlyer atë nga kredimarrësi dhe/ose garantuesi. Kjo karakteristikë konsiderohet e pavarur nga të tjerat, për klasifikimin e kredive si kredi me probleme;

g) karakteristika të tjera të parashikuara në dokumentet e bankës, të cilat pranohen vetëm kur kredia klasifikohet në një kategori me cilësi më të ulët se ajo e parashikuar nga analiza e karakteristikave të mësipërme.

5.2 Inspektorët e mbikëqyrjes kanë të drejtë të kërkojnë ndryshimin e kategorisë së klasifikimit të kredive në rastet kur:

- gjykojnë se interpretimi i kritereve të mësipërme nga bankat nuk është i drejtë;
- gjykojnë se ka elemente të tjera shtesë, përveç karakteristikave të mësipërme, që e justifikojnë ndryshimin e kategorisë së klasifikimit.

Kërkesa të përgjithshme

Neni 6

Bankat, miratojnë në këshillin drejtues, dokumentet e politikave, të procedurave dhe të rregullave të brendshme për monitorimin dhe për kontrollin në vazhdimësi të cilësisë së portofolit të kredive dhe të aktiveve të tjera të bankës. Këto dokumente duhet të përmbajnë minimalisht:

a) strategjinë e kreditimit;

b) politikat e normave të interesit, të afateve, të shlyerjeve dhe të madhësisë së kredive;

c) rregullat e vendosura për njohjen dhe analizën e kredimarrësit dhe/ose të garantuesit të kredisë;

d) procedurat për dokumentacionin e nevojshëm që duhet plotësuar për dhënien e kredive, si edhe për miratimin e kredisë, sipas hierarkisë;

e) politikat e administrimit të rrezikut për të gjithë portofolin dhe për çdo klient në veçanti, kufijtë e kredisë për një klient, përqendrimin e kredisë sipas sektorëve dhe raportin e rrezikut të kredisë me rreziqet e tjera (ndryshimi i kursit të këmbimit, ndryshimi i normës së interesit etj.);

f) procedurat për ndjekjen në vazhdimësi të mbarëvajtjes së kredive, për ndjekjen me përparësi të kredive me probleme, për rivlerësimin e vazhdueshëm të garancive apo të kolateraleve dhe për vlerësimin e mjaftueshmërisë së fondeve rezervë për humbjet e mundshme nga kreditë;

g) procedurat për vlerësimin e cilësisë së aktiveve të tjera, për angazhimet e dhëna për financimet, për llogaritjen e fondeve rezervë për humbjet e mundshme nga zhvlerësimi i aktiveve, si dhe për vlerësimin e mjaftueshmërisë së tyre;

h) procedurat e miratimit dhe të administrimit për kreditë kufi (sipas kuptimit në pikën 2.3.3 “kredi me llogari të zbuluar” të Manualit të Kontabilitetit Bankar, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.820, datë 30.12.1998).

Rregulla të përgjithshme të bankës

Neni 7

Manualet dhe/ose politikat e bankës, duhet të kërkojnë të vlerësohet në vazhdimësi jo vetëm cilësia e portofolit të kredive dhe e aktiveve të tjera, por edhe rreziku i humbjes si rezultat i zhvlerësimit të tyre. Për këtë, në këto dokumente përcaktohen minimalisht:

7.1 Mënyra e organizimit të procesit të ndjekjes së kredisë duke përfshirë, por duke mos u kufizuar nga elementet e mëposhtme:

a) njësitë administrative që merren me vlerësimin e rrezikut, me përllogaritjen e provigjoneve dhe ekzekutimin e tyre;

b) metodat e vlerësimit të aftësisë shlyerëse të kredimarrësit (duke përfshirë rreziqet që mund të paraqesë kreditimi në rastet kur njësia monetare e dhënies së kredisë është e ndryshme nga njësia monetare në të cilën janë të ardhurat e kredimarrësit etj.), të garancive dhe të kolateraleve përkatëse;

c) bashkëveprimin me njësitë e pavarura të kontrollit të brendshëm dhe/ose të jashtëm;

d) periodicitetin e vlerësimit, të klasifikimit dhe të parashikimit për fonde rezervë për mbulimin e rrezikut;

e) periodicitetin e raportimit për administratorët e bankës.

7.2 Mënyra e kryerjes së analizës së gjendjes financiare të kredimarrësit dhe të besueshmërisë së tij (si element parësor në klasifikimin e kredisë), duke përfshirë, por duke mos u kufizuar nga elementet e mëposhtme:

a) madhësia dhe burimi i të ardhurave të kredimarrësit për shlyerjen e kredisë;

b) kreditë e tjera dhe rregullshmëria e shlyerjes së tyre;

c) kreditë ndaj personave të lidhur dhe rregullshmëria e shlyerjes së tyre;

d) bilanci kontabël dhe llogaria e rezultatit financiar (Humbje e fitime);

e) biznesplani dhe pasqyra e fluksit të rrjedhjes së parave dhe parashikimit për të ardhmen;

f) historia e shlyerjes së kredive në të kaluarën dhe në vazhdimësi;

g) kapaciteti shlyerës i kredisë për personat fizikë dhe juridikë nga analiza e ciklit të biznesit të kredimarrësit.

7.3 Mënyra e kryerjes së analizës së gjendjes financiare të garantuesit të kredisë dhe të besueshmërisë së tij.

Kjo analizë bëhet me qëllim që të vlerësohet aftësia ripaguese e garantuesit dhe të mbështetet mbi të njëjtat dokumente, mbi bazën e të cilave bëhet analiza e gjendjes financiare të kredimarrësit.

7.4 Mënyra e kryerjes së analizës së sigurimit të kredisë, e cila ka për qëllim të vlerësojë nëse një kredi është apo nuk është e siguruar mirë.

Me kredi të siguruar mirë kuptojmë që kolaterali ose garancia e përdorur për të siguruar këtë kredi, është e mjaftueshme që të mbrojë bankën nga humbja e kryegjësë dhe e interesit.

Me mjaftueshmëri në këtë rast, kuptojmë ekzistencën e një dokumentacioni ligjor, që siguron bankën se me ekzekutimin e kolateralit dhe/ose të garancisë, do të mbulojë sasinë e kryegjësë dhe të interesit, si dhe koston e mbledhjes ose të ekzekutimit të kolateralit dhe/ose të garancisë.

Kreditë standarde

Neni 8

Bankat klasifikojnë si “kredi standarde” të gjitha kreditë, përveç atyre të klasifikuara sipas neneve 9,10,11 dhe 12.

Kur kësti i kredive standarde, që shlyhen me këste, nuk është paguar në afat për një periudhë prej 1 deri në 30 ditë, atëherë vetëm kësti i papaguar klasifikohet në rubrikën 2.1 të Manualit të Kontabilitetit Bankar (“kredi dhe paradhënie të pakthyera në afat për klientin”) dhe kjo shumë përfshihet gjithashtu, në kredinë standarde.

Kreditë në ndjekje

Neni 9

Bankat klasifikojnë si “kredi në ndjekje”, kreditë, të cilat paraqiten me të paktën një nga karakteristikat e mëposhtme:

1. Gjendja financiare e kredimarrësit vlerësohet e mirë, por me dobësi të mundshme të gjendjes financiare të kredimarrësit në një kohë të ardhme;

2. Gjendja financiare e garantuesit të kredisë vlerësohet e mirë;

3. Kredia vlerësohet si “e siguruar mirë”, sipas përcaktimeve në nenin 7 pika 7.4 të kësaj rregulloreje;

4. Kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 1 deri 30 ditësh nga afati i maturimit në rastet kur kredia nuk shlyhet me këste;

5. Kryegjëja ose interesi, nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 31 deri 90 ditësh nga afati i maturimit në rastet kur kredia shlyhet me këste;

6. Kredimarrësi nuk ka lëvizje në llogari për 31 deri 60 ditë për rastet kur kemi të bëjmë me kredi kufi.

Kreditë nënstandarde

Neni 10

Bankat klasifikojnë si “kredi nënstandarde”, kreditë, të cilat paraqiten me të paktën një nga karakteristikat e mëposhtme:

1. Gjendja financiare e kredimarrësit vlerësohet jo e kënaqshme, pasi të ardhurat e tij nga aktiviteti kryesor gjykohen të pamjaftueshme;

2. Gjendja financiare e garantuesit të kredisë vlerësohet e mirë, por parashikohen probleme në të ardhmen;

3. Kredia vlerësohet se nuk është e siguruar mirë, vlera e kolateralit dhe/ose e garancisë vlerësohet se nuk është në përputhje me nenin 7 pika 7.4 të kësaj rregulloreje;

4. Kur kryegjëja ose interesi nuk janë paguar plotësisht për një periudhë prej 31 deri 90 ditësh nga afati i maturimit, për rastet kur kredia nuk shlyhet me këste;

5. Kur kryegjëja ose interesi nuk janë paguar plotësisht për një periudhë prej 91 deri 180 ditësh nga afati i maturimit, për rastet kur kredia shlyhet me këste;

6. Kur kredimarrësi nuk ka lëvizje në llogari për 61 deri 180 ditë, për rastet kur kemi të bëjmë me kredinë kufi;

7. Kredia është ristrukturuar një herë nga paaftësia për ta paguar atë dhe plotësohen në të njëjtën kohë kushtet e mëposhtme:

a) kredia nuk po shlyhet për vlerën e kryegjësë dhe të interesit, sipas kushteve të reja;

b) pavarësisht nga ecuria e kredisë me kushtet e reja, nuk kanë kaluar më tepër se 365 ditë nga dita e ristrukturimit.

Kreditë e dyshimta

Neni 11

Bankat klasifikojnë si “kredi të dyshimta”, kreditë, të cilat paraqiten me të paktën një nga karakteristikat e mëposhtme:

1. Gjendja financiare e kredimarrësit nuk vlerësohet e mjaftueshme për të paguar në total detyrimin e tij mbi kredinë ose detyrime të tjera të tij ndaj bankës ose ndaj personave të tretë;

2. Deklarimi i kredimarrësit si “i falimentuar”, vlerësohet si një mundësi reale;

3. Gjendja financiare e garantuesit të kredisë nuk vlerësohet e mjaftueshme për të përmbushur angazhimet e dhëna ndaj kredimarrësit dhe ndaj bankës, të paktën përkohësisht;

4. Kredia vlerësohet se nuk është e siguruar mirë, sipas përcaktimit në nenin 7 pika 7.4 të kësaj rregulloreje;

5. Kur kryegjëja ose interesi, nuk janë paguar plotësisht për një periudhë prej 91 deri 180 ditësh nga afati i maturimit, për rastet kur kredia nuk shlyhet me këste;

6. Kur kryegjëja ose interesi, nuk janë paguar plotësisht për një periudhë prej 181 deri 365 ditësh nga afati i maturimit, për rastet kur kredia shlyhet me këste;

7. Kur kredimarrësi nuk ka lëvizje në llogari për 181 deri 365 ditë, për rastet kur kemi të bëjmë me kredinë kufi;

8. Kredia është ristrukturuar dy herë për shkak të paaftësisë për ta paguar atë dhe plotësohen në të njëjtën kohë kushtet e mëposhtme:

a) që prej ristrukturimit të fundit, kredia nuk po shlyhet për vlerën e kryegjësë dhe të interesit, sipas kushteve të reja;

b) pavarësisht nga ecuria e kredisë me kushtet e reja, nuk kanë kaluar më tepër se 550 ditë nga dita e ristrukturimit të fundit.

9. Banka ka vepruar juridikisht (ka bërë kërkesë pranë gjykatës së rrethit), për të filluar procesin e ekzekutimit të kolateralit nga ana e zyrës së përmbarimit.

Kreditë e humbura

Neni 12

Bankat klasifikojnë si kredi të humbura ato kredi, të cilat paraqiten me të paktën një nga karakteristikat e mëposhtme:

1. Gjendja financiare e kredimarrësit vlerësohet qartë si e paaftë për përmbushjen e kushteve të shlyerjes së kryegjësë dhe të interesit;

2. Kredimarrësi ka falimentuar, është përfshirë në proces likuidimi dhe ekziston rreziku që disa kreditorë të mbeten të pakënaqur;

3. Kredimarrësi ka vdekur dhe askush nuk mund të paguajë kredinë;

4. Banka ka vepruar juridikisht dhe në mënyrë përfundimtare (ka dalë vendimi i gjykatës dhe është kryer pagesa për shërbimin e ekzekutimit të kolateralit), për të realizuar procesin e ekzekutimit të kolateralit nga ana e zyrës së përmbarimit;

5. Të njëjtat pasuri të kredimarrësit janë lënë peng ose janë hipotekuar edhe për kreditorë të tjerë dhe banka nuk mund t'i ekzekutojë në kohën dhe mënyrën e nevojshme, për të rekuperuar vlerën e kredisë;

6. Gjendja financiare e garantuesit të kredisë vlerësohet se nuk mund të përmbushë angazhimet e dhëna ndaj kredimarrësit dhe ndaj bankës në vazhdimësi;

7. Kredia vlerësohet se nuk është e siguruar mirë, sipas përcaktimit në nenin 7 pika 7.4 të kësaj rregulloreje;

8. Kur kryegjëja ose interesi nuk janë paguar plotësisht për një periudhë prej më shumë se 181 ditësh nga afati i maturimit, për rastet kur kredia nuk shlyhet me këste;

9. Kur kryegjëja ose interesi nuk janë paguar plotësisht për një periudhë prej më shumë se 365 ditësh nga afati i maturimit për rastet kur kredia shlyhet me këste;

10. Kur kredimarrësi nuk ka lëvizje në llogari për më shumë se 365 ditë, për rastet kur kemi të bëjmë me kredi kufi;

11. Kredia është ristrukturuar për më shumë se dy herë, për shkak të paaftësisë paguese.

Kontabiliteti i interesave

Neni 13

Për kreditë e klasifikuara sipas nenit 10, të cilat janë të pashlyera për më shumë se 90 ditë, si edhe për kreditë e klasifikuara sipas nenit 11 dhe sipas nenit 12, interesat e llogaritura nuk kontabilizohen.

Në rastet kur kredimarrësi shlyen detyrimin, në detyrim përfshihet edhe llogaritja e interesave të pakontabilizuara. Kjo bëhet për të mos rënduar bilancin e bankës për ato vlera të interesit, që janë të pasigurta për t'u arkëtuar.

Arkëtimet pasuese që merr banka, duhet të përdoren më parë për shlyerjen e interesit të të gjithë periudhës dhe më pas të kryegjësë.

Normat e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë

Neni 14

1. Në varësi të kategorive të klasifikimit të kredive, bankat krijojnë fonde përkatëse rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga moskthimi i kredive. Normat e llogaritjes së fondeve rezervë janë:

A. Norma fikse për grupin e kredive cilësore:

1. për “kredinë standarde” dhe “kredi dhe paradhënie të pakthyera në afat për klientin”.....1 për qind;

2. për “kredinë në ndjekje”.....5 për qind.

Fondet rezervë për kreditë e mësipërme llogariten mbi vlerën e përbashkët të kryegjësë dhe të interesit dhe konsiderohen fonde rezervë për mbulimin e rrezikut statistikor.

B. Norma të ndryshueshme për grupin e kredive me probleme:

- për kryegjënë:

3. “kredia nënstandarde” jo më e vogël se 20 për qind;

4. “kredia e dyshimtë” jo më e vogël se 50 për qind;

5. “kredia e humbur” jo më e vogël se 100 për qind.

- për interesin e përllogaritur norma është 100 për qind në çdo rast.

Fondet rezervë të llogaritura për kreditë me probleme konsiderohen fonde rezervë për mbulimin e rrezikut të zhvlerësimit të kredive.

2. Nëse për një kredi plotësohen në të njëjtën kohë kushtet e mëposhtme:

a) për sigurimin e të gjithë kredisë (ose të një pjese të saj) është përdorur si kolateral dhe/ose si garanci një depozitë/llogari bankare në *cash*, për të cilën

b) banka ka në mënyrë të dokumentuar të gjitha të drejtat ligjore dhe mundësitë fizike për zotërimin dhe për përfitimin e kolateralit/garancisë në favor të bankës në kohën dhe në mënyrën e nevojshme, nëse kredimarrësi nuk respekton kushtet e kthimit të kredisë, atëherë banka, duke analizuar të gjitha llojet e rreziqeve, mund ta klasifikojë kredinë (ose pjesën e saj të kolateralizuar me *cash*) në kategorinë në të cilën ajo është e sigurtë që vlera e kolateralit dhe/ose e garancisë së kredisë (ose e pjesës së saj të kolateralizuar me *cash*), së bashku me vlerën e fondeve rezervë të krijuara sipas kuptimit të këtij neni, por jo domosdoshmërisht sipas kërkesave të tij, mbulojnë në mënyrë të mjaftueshme vlerën e kryegjësë dhe të interesit të kredisë (ose të pjesës së saj të kolateralizuar me *cash*).

Kontabiliteti i klasifikimit të kredive dhe fondeve rezervë
për mbulimin e humbjeve nga kreditë

Neni 15

Në të njëtën kategori me kredinë (kryegjënë dhe interesin) që klasifikohet, klasifikohen edhe llogaritë e tjera që lidhen me të, të cilat përfaqësojnë kredi të dhëna nga banka për persona të lidhur dhe të varur financiarisht nga kredimarrësi dhe/ose garanci të dhëna nga banka për të njëjtin kredimarrës ose për persona të lidhur dhe të varur financiarisht prej tij.

Fondet rezervë të llogaritura sipas nenit të mësipërm regjistrohen si shpenzim.

Nëse një kredi riklasifikohet nga njëra kategori tek tjetra:

1. Teprica e kredisë gjithsej (kryegjë dhe interes), si edhe llogaritë e tjera të lidhura me të, të cilat përfaqësojnë kredi të dhëna nga banka për persona të lidhur dhe të varur financiarisht nga kredimarrësi dhe/ose garanci të dhëna nga banka për të njëjtin kredimarrës ose për persona të lidhur dhe të varur financiarisht prej tij, klasifikohen në të njëjtën kategori.

2. Fondet rezervë të llogaritura regjistrohen si “të ardhura” nga rimarrja e fondeve rezervë dhe fondet rezervë të krijuara, sipas klasifikimit të kredisë në kategorinë e re, regjistrohen si “shpenzime”.

Për vlerësimin e kredive, në përputhje me këtë rregullore, bankat dhe degët e bankave të huaja plotësojnë, për çdo kredi, formularin nr.1 bashkëlidhur, i cili ruhet në dosjen e kredimarrësit.

Kapitalizimi i interesit

Neni 16

Kapitalizimi i interesit është procesi në të cilin “interesi i llogaritur” bashkohet me kryegjënë, duke u regjistruar në llogarinë e kryegjësë.

Kapitalizimi i interesit nga bankat, ndodh vetëm nëse plotësohen në të njëjtën kohë kushtet e mëposhtme:

1. Kredimarrësi është në gjendje të paguajë detyrimet e tij nga të ardhurat e veprimtarisë;

2. Kapitalizimi i interesit është parashikuar në kushtet dhe afatet e marrëveshjes fillestare të kredisë, në rast vështirësie likuiditeti të kredimarrësit;

3. Kredia, përfshirë dhe interesin e kapitalizuar, është garantuar mirë;

4. Planbiznesi i kredimarrësit krijon besim që në të ardhmen gjendja financiare do të përmirësohet ndjeshëm ose të ardhurat e tij të veprimtarisë do të rriten në mënyrë të konsiderueshme;

5. Nuk ka rrezik të menjëhershëm për humbje të kredisë, përfshirë dhe interesin e kapitalizuar;

6. Kredimarrësi mund të sigurojë fonde për shlyerjen e kredisë nga burime të tjera në shumën dhe kohën e njëjtë me maturimin e kredisë.

Ristrukturimi i kredisë

Neni 17

Bankat, në marrëveshje me kredimarrësin, ristrukturojnë kredinë në rastin kur kredimarrësi nuk shlyen kredinë në përputhje me afatet dhe me kushtet e marrëveshjes fillestare, sipas kritereve të përcaktuara në manualin e kredisë të miratuar nga këshilli drejtues i bankës. Në rast të ristrukturimit të kredisë, në dosje shtohet edhe marrëveshja e ristrukturimit e lidhur ndërmjet bankës dhe kredimarrësit.

Fshirja e kredive të humbura

Neni 18

1. Fshirja e kredive të humbura bëhet me vendim të këshillit drejtues të bankës kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) Banka ka përfunduar procesin ligjor të kërkimit të kthimit të kredisë nga kredimarrësi dhe kredimarrësi është debitor i bankës për pjesën e pashlyer;

b) Me vendim të këshillit drejtues, kredia është përfshirë në listën e kredive të humbura që mund të fshihen dhe ka përfunduar afati i qëndrimit në këtë listë;

c) Kur kredia është e klasifikuar si "e humbur" dhe nuk është shlyer për më tepër se 365 ditë pas klasifikimit si e tillë;

d) Kredia është vlerësuar si e humbur nga inspektorët e mbikëqyrjes dhe në raportin e inspektimit, është kërkuar fshirja e saj.

2. Dosjet e kredive të fshira ruhen dhe vlerësohen në vazhdimësi, duke u shqyrtuar jo më pak se një herë në gjashtë muaj nga këshilli drejtues i bankës. Çdo arkëtim nga këto kredi të fshira konsiderohet si e ardhur e jashtëzakonshme.

Klasifikimi i aktiveve të tjera, i angazhimeve të financimit të dhëna

Neni 19

Aktivet e tjera, si edhe angazhimet e dhëna të financimit klasifikohen në dy kategori:

1. standarde ose të rregullta;

2. të dyshimta ose me probleme.

Politikat e klasifikimit të aktiveve të tjera dhe të angazhimeve të dhëna të financimit në kategorinë "të dyshimta ose me probleme", si edhe madhësia e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga humbja e vlerës së tyre, miratohen nga këshilli drejtues i bankës.

Madhësia e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga rënia e vlerës së aktiveve të tjera, të cilat janë të ndjeshme ndaj lëvizjeve të normave të interesit, nuk duhet të jetë më e vogël se interesi i përllogaritur.

Regjistrimet në kontabilitet kryhen sipas të njëjtës metodologji të përcaktuar në nenin 15 të kësaj rregulloreje.

Raportimi

Neni 20

Bankat bëjnë klasifikimin e kredive dhe të aktiveve të bankës dhe llogaritjen e fondit rezervë për mbulimin e humbjeve, të paktën një herë në tre muaj.

Ato hartojnë dhe paraqesin në Bankën e Shqipërisë formularët bashkëlidhur kësaj rregulloreje (formularët nr.2 dhe nr.3 janë pjesë përbërëse të sistemit raportues të unifikuar, ndërsa formularët 4, 5 dhe 6 raportohen çdo tre muaj në Departamentin e Mbikëqyrjes).

Neni 21

Banka e Shqipërisë mund të kërkojë në çdo kohë nga bankat të dhëna shtesë dhe analitike, mbi mënyrën e administrimit të rrezikut të kredisë dhe të krijimit të fondit rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë.

Raste të veçanta

Neni 22

Manualet e miratuara nga këshilli drejtues i bankës përmbajnë rregulla të veçanta në përputhje me rregulloren “Për marrëdhëniet e bankës me personat e lidhur”.

Kreditë ndaj “personave të lidhur” vlerësohen në vazhdimësi, duke u shqyrtuar jo më pak se një herë në gjashtë muaj nga këshilli drejtues i bankës.

Dispozita përfundimtare

Neni 23

Për shkelje të dispozitave të kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë zbaton nenet 44 dhe 45 “Për shkeljet dhe dënimet” të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

Neni 24

Rregullorja "Për administrimin e rrezikut të kredisë” miratuar me vendimin nr.13, datë 21.2.2001 dhe ndryshimi i bërë me vendimin nr.32, datë 8.5.2002 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, shfuqizohen.

Neni 25

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Shkëlqim Cani

Formulari 1

TË DHËNA PËR TEPRICËN E KREDISË SË KLIENTIT

		Periudha e vlerësimit			
Nr.		31.3.....	30.6.....	30.9....	31.12.....
1	Sfera e aktivitetit				
2	Forma e pronësisë				
3	Qëllimi i dhënies të kredisë				
4	Lloji i kredisë (sipas afatit)				
5	Detyrimi në garanci dhënë bankës				
6	Shuma totale e papaguar :				
	- kryegjëja				
	- interesi				
7	Pozicioni financiar i huamarrësit :				
	- i besueshëm , i mirë				
	- jo i besueshëm				
	- jo i kënaqshëm				
	- i keqësuar				
	- i falimentuar				
8	Sigurimi i kredisë				
	- i mjaftueshëm , i siguruar mirë				
	- i pamjaftueshëm , jo i siguruar mirë				
9	Ripagimi i kryegjësë dhe pagimi i interesit :				
	- i paguar në afatin e maturimit				
	- nuk është paguar për 1-30 ditë				
	- nuk është paguar për 31-90 ditë				
	- nuk është paguar për 91-180 ditë				
	- nuk është paguar mbi 181 ditë				
	- kësti nuk është paguar për 1-30 ditë				
	- kësti nuk është paguar për 31-90 ditë				
	- kësti nuk është paguar për 91-180 ditë				
	- kësti nuk është paguar për 181-360 ditë				
	- kësti nuk është paguar mbi 361 ditë				
10	Numri i ristrukturimit të kredisë				
11	Klasifikimi i kredisë :				
	- kredi standarde , hua dhe paradhënie të pakthyera në afat për klientin (kësti)				
	- kredi në ndjekje				
	- kredi nënstandarde				
	- kredi të dyshimta				

	- kredi të humbura				
12	Provigjone për kreditë (sipas afatit)				
13	Provigjone për garancitë e dhëna				

Formulari 2

FONDE REZERVË PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NGA KREDITË

Tabela nr.1		Kryegjëja				Fonde rezervë për kryegjënë			
Nr.	Klasifikimi i kredisë	Kredi për klientelën	Kredi ndër bankare	Angazhime të dyshimta	Norma për provigjone	Kredi për klientelën	Kredi ndër bankare	Angazhime të dyshimta	Shuma
		1	2	3	4	5=1*4	6=2*4	7=3*4	8=5+6+7
1	Kredi standarde dhe kredi e pakthyer në afat (kësti)				0.01				
2	Kredi në ndjekje				0.05				
3	Kredi nënstandarde				0.20				
4	Kredi të dyshimta				0.50				
5	Kredi të humbura				1.00				
6	TOTALI								

Tabela nr.2		Interesat e llogaritur			Fonde rezervë për interesat		
Nr	Klasifikimi i kredisë	Kredi për klientelën	Kredi ndër bankare	Norma për provigjone	Kredi për klientelën	Kredi ndër bankare	Shuma
		1	2	3	4=1*3	5=2*3	6=4+5
1	Kredi standarde dhe kredi e pakthyer në afat (kësti)			0.01			
2	Kredi në ndjekje			0.05			
3	Kredi nënstandarde			1.00			
4	Kredi të dyshimta			1.00			
5	Kredi të humbura			1.00			
6	TOTALI						

Tabela nr.3		Rimarrje e fondit rezervë për kryegjënë				Rimarrje e fondit rezervë për interesat			
Nr	Klasifikimi i kredisë	Kredi për klientelën	Kredi ndër bankare	Angazhime të dyshimta	Shuma për kryegjënë	Kredi për klientelën	Kredi ndër bankare	Shuma për interesat	SHUMA
		1	2	3	4=1+2+3	5	6	7=5+6	8=4+7
1	Kredi standarde dhe kredi e pakthyer në afat (kësti)								
2	Kredi në ndjekje								
3	Kredi nënstandarde								
4	Kredi të dyshimta								
5	Kredi të humbura								
6	TOTALI								

Formulari nr.3

FONDET REZEVË TË KRIJUARA NGA BANKAPËR MBULIMIN E HUMBJEVE NGA KREDITË

Numrat e llogarive	Emërtimi i llogarive	Teprica në fillim 1(+)	Shtimi i provigjoneve 2 (+)	Rimarrja e provigjoneve 3 (+)	Kreditë e fshira gjatë periudhës 4(-)	Korrigjime të bëra gjatë periudhës 5 (+ose)	Teprica në fund të periudhës (6= 1+2+3-4±5)
128							
198							
238							
248							
258							
268							
298							
3128							
3138							
3228							
418							
518							
528							
538							
551							
558							

Formulari nr.4
Kredia në valutë dhe flukset e fondeve të klientëve

Objekti i kredisë në valutë	Vlera e portofolit të kredisë në total	Vlera e portofolit të kredisë në valutë	Teprica e kredisë në valutë	Nr. i kredive të pamaturuara në valutë	Nr.i kredive në valutë, ku klienti nuk kryen aktivitet në valutë	Teprica e kredisë në valutë, ku klienti nuk kryen aktivitet në valutë
	(000 lekë)	(000 lekë)	(000 lekë)			(000 lekë)
	(a)	(b)	c)	(d)	(e)	(f)
Për tregti						
Për pasuri të paluajtshme						
Për zhvillim biznesi						
Kredi konsumatore						
Të tjera						
Totali						

Kursi i këmbimit i përdorur në plotësimin e formularit : 1 EUR = _____ Lekë ; 1 USD = _____ Lekë] Burimi : _____

Sqarim:

- Në kolonën (e) do të regjistrohet numri i kredive për të cilat, sipas bankës, klienti nuk i gjeneron të ardhurat kryesore të tij në valutë

Formulari nr.5
Kredia në valute dhe cilësia

Objekti i kredisë në valutë	Teprica e kredisë në valutë, ku klienti nuk kryen aktivitet në valutë.	Në euro	Kredi me probleme	Kursi mesatar i këmbimit (EUR/Lek) në momentin e disbursimit të plotë	Totali i provigjioneve për kredinë në euro	Në USD	Kredi me probleme	Kursi mesatar i këmbimit (USD/Lek) në momentin e disbursimit të plotë	Totali i provigjioneve për kredinë në USD	Totali i provigjioneve
	(000 lekë)	(000 lekë)	(000 lekë)		(000 lekë)	(000 lekë)	(000 lekë)		(000 lekë)	(000 lekë)
	'(1) = (2) + (6)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10) = (5) + (9)
Për tregti										
Për pasuri të paluajtshme										
Për zhvillim biznesi										
Kredi konsumatore										
Të tjera										
Totali										

Kursi i këmbimit i përdorur në plotësimin e formularit: 1 EUR = _____ Lek ; 1 USD = _____ Lek
Burimi : _____

Sqarim :
Kolonat e këtij formulari (nga numri (2) deri në numrin (10)) plotësohen në funksion të natyrës së kredisë të paraqitur në kolonën (1).

Në kolonen (1) shenohen vlerat që merren nga kolona (e) e formularit nr.4." Kredia në valutë dhe flukset e fondeve te klienteve"

Kolona (3) mbushet sipas kuptimit të termit "kredi me probleme", përkufizuar në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë".

Për kreditë që janë disbursuar me disa këste, kursi i këmbimit në momentin e disbursimit të plotë, do të jetë kursi i këmbimit mesatar i ponderuar me pjesët e kredisë të disbursuara, në momentin e disbursimit.

Formulari nr.6

Kredia në valutë dhe struktura e kohëzgjatjes

Objekti i kredisë në valutë	Teprica e kredisë në valutë, ku klienti nuk kryen aktivitet në valutë*	Në euro	Mbetur në maturim deri në 1 vit	Mbetur në maturim deri në 5 vjet	Mbetur në maturim mbi 5 vjet	Në USD	Mbetur në maturim deri në 1 vit	Mbetur në maturim deri në 5 vjet	Mbetur në maturim mbi 5 vjet
	(000 lekë)	(000 lekë)	(000 lekë)	(000 lekë)	(000 lekë)	(000 lekë)	(000 lekë)	(000 lekë)	(000 lekë)
	(1) = (2) + (6)	(2)=(3+4)+ (5)	(3)	(4)	(5)	(6)=(7)+(8) + (9)	(7)	(8)	(9)
Për tregti									
Për pasuri të paluajtshme									
Për zhvillim biznesi									
Kredi konsumatore									
Të tjera									
Totali									

Kursi i këmbimit i përdorur në plotësimin e formularit : 1 EUR = _____ Lek ; 1 USD = _____ Lek
Burimi : _____